



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 68, Datë 11.04.2022

MBI

**KËRKESËN E KONCESIONARIT “TEODORI” SH.P.K., PËR TRANSFERIMIN E  
PLOTË TË LICENCËS SË SHOQËRISË KONCENSIONARE “TEODORI 2003”  
SH.P.K., NR. 87, SERIA PV09K, DHËNË PËR VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “ZALLI I BULQIZËS” DHE HEC “TERNOVË”,  
TEK SHOQËRIA “TEODORI” SH.P.K.**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 10, pika 3, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, si dhe nenit 19, pika 1, gërma “a”, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 11.04.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 434/11 prot., datë 08.04.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e koncesionarit “TEODORI” sh.p.k., për transferimin e plotë të licencës së shoqërisë koncensionare “TEODORI 2003” sh.p.k., nr. 87, Seria PV09K, dhënë me vendimin e bordit nr. 83, datë 04.11.2009, për një afat 30 vjeçar, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Zalli i Bulqizës” dhe HEC “Ternovë”, tek shoqëria “TEODORI” sh.p.k.”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria Koncesionare “TEODORI” sh.p.k. i është drejtuar ERE-s në cilësinë e Organit Shtetëror të Autorizuar (OSHA), me shkresën nr. 336 prot., datë 02.03.2022, për transferim licence. Në të tilla rrethana, ERE me shkresën nr. 336/1 prot., datë 18.03.2022 i është përgjigjur shoqërisë duke e sqaruar se: Enti Rregullator i Energjisë është autoriteti rregullator i sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror, i cili funksionon në përputhje me ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar. Ndërsa Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA) është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, ndaj si e tillë duhet të adresohet saktë kërkesa.
- Në vijim të sa më sipër shoqëria “TEODORI” sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 336/2 prot., datë 24.03.2022, iu drejtua ERE-s në cilësinë e organit publik, i cili ka kompetencë për nxjerrjen dhe transferimin e licencave të prodhimit të energjisë elektrike duke kërkuar transferimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike tek shoqëria

koncesionare “TEODORI” sh.p.k., duke prashtruar ndër të tjera se: *ky transferim duhet të bëhet me qëllim që shoqëria “TEODORI” sh.p.k. të lidhë kontratën me FTL sh.a. për shitblerjen e energjisë elektrike me pretendimin se zotëron të drejtat koncesionare.*

- Shoqëria “TEODORI” sh.p.k. e cila i është drejtuar ERE-s me kërkesën e protokolluar me nr. 336/2 prot., datë 24.03.2022, nuk është në statusin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “TEODORI 2003” sh.p.k.
- Shoqëria “TEODORI 2003” sh.p.k., është mbajtëse e licencës nr. 87, Seria PV09K, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 83, datë 04.11.2009, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Zalli i Bulqizës” me kapacitet të instaluar 5.350 MW dhe HEC “Tërnovë” me kapacitet të instaluar 8.385 MW.
- Referuar nenit 17, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, përcaktohet se: *Kërkesa për transferimin e licencës bëhet nga i licencuari në ERE dhe/ose me iniciativën e kësaj të fundit, mund të transferojë plotësisht dhe pjesërisht licencën e një të licencuari në përputhje me Ligjin Nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.*
- Mbështetur në referencën e sipërcituar, vlerësohet se nuk jemi në asnjë nga rastet e parashikuara në pikën 1, të nenit 17, kjo për arsye se duke marrë parasysh parashikimin: *“...Kërkesa për transferimin e licencës bëhet nga i licencuari në ERE...”*, vlen të theksojmë se nga analizimi i kërkesës së shoqërisë “TEODORI” sh.p.k., rezulton se kjo e fundit nuk është shoqëri e licencur nga ERE dhe si e tillë nuk legjitimohet për të vijuar më tej me pranimin e kërkesës së saj.
- Po ashtu edhe sa i përket parashikimit: *“...dhe/ose me iniciativën e kësaj të fundit...”*, pra me iniciativën e ERE-s, nuk jemi në këto kushte pasi nga shoqëria “TEODORI” sh.p.k. nuk janë paraqitur rrethana apo fakte që mund të çojnë ERE-n në një vendimmarrje me iniciativën e saj.
- Gjithashtu nuk jemi as në rastin e parashikuar në pikën 2, të nenit 17, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, i cili citon se: *“Ne rastet e transferimit të plotë të asetëve sipas rregullores së miratuar nga ERE për këtë qëllim, personit jo të licencuar tek i cili do të transferohen asetet do t’i transferohet licenca pasi ai të paraqesë një aplikim në ERE për transferimin e licencës duke paraqitur dokumentat...”*, pasi ERE nuk ka kryer asnjë transferim asetesh të shoqërisë “TEODORI 2003” sh.p.k. tek një person jo i licencuar.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të mos fillojë procedurën për transferimin e licencës së shoqërisë koncensionare “TEODORI 2003” sh.p.k., me nr. 87, Seria PV09K, dhënë me vendimin e bordit nr. 83, datë 04.11.2009, për një afat 30 vjeçar, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Zalli i Bulqizës” dhe HEC “Tërnovë”, tek shoqëria “TEODORI” sh.p.k.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**